



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 801/1 Prot.

Tiranë, më 23 .05 .2022

V E N D I M

Nr. 90, Datë 23 .05 .2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 22, datë 01.02.2022, të S.Ç kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi informon se i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe gëzon Statusin e të Verbërit. Në muajin Shtator 2018 ka filluar studimet me kohë të plotë pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, në programin 2-vjeçar, me karakter Profesional në degën “Menaxhim i Biznesit Bujqësor”. Gjatë vitit të parë të studimeve, ankuesi mbështetur në VKM-në nr. 227, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, të ndryshuar, ka përfutuar pagesën për shkak të aftësisë së kufizuar. Vitin e dytë për shkak të gjendjes shëndetësore ka lënë studimet dhe e ka vazhduar një vit me vonesë. Gjatë kësaj periudhe është paguar për dy muaj (nëntor-dhjetor) dhe në muajin janar i është ndërprerë bursa me pretendimin se është ndryshuar ligji. Edhe pse në këto kushte me vështirësi e ka paguar shkollën dhe është diplomuar në muajin Korrik 2021.

¹ Referuar Librezës së Verbërisë Nr. 09171, datë 07.07.2020 lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, i cili gëzon Statusin e të Verbërit kategoria e II-të.

Në vijim ankuesi i është drejtuar DRSHSSH Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë të cilët i janë përgjigjur se nuk i takon pagesa për vitin plus, sepse ka ndryshuar ligji.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rimbursimin e pagesës për periudhën që duhet ta përfitonte atë.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 22, datë 01.02.2022, të bërë nga S.Ç, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 223/1, datë 07.02.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DRSHSSH Korçë dhe Bashkia Korçë, për ankesën e bërë nga S.Ç si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Informacion lidhur me arsyet e përjashtimit të ankuesit nga përfitimi i pagesës 1 (një) vit plus për programin e studimit Master Profesional.
 - A ka patur ankesa të tjera nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me S.Ç? Nëse po, a është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe sa është numri i tyre?
 - A ka paraqitur S.Ç, ankesë pranë DRSHSSH Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, lidhur me pretendimet e ngritura? Nëse po, kërkohet një kopje e korrespondencës.

Me shkresën nr. 252/1, datë 16.02.2022, DRSHSSH Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Shtetasi S.Ç, trajtohet me pagesë paaftësie (status verbërie) dhe ka ndjekur programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Menaxhim Biznesi Bujqësor”, pranë Universitetit Fan S.Noli, Korçë.

Për vitin akademik 2019-2020 ka marrë pagesë 300%, për shkak të frekuentimit të arsimit të lartë, të parashikuar sipas pikës 7, VKM nr. 277, datë 18.06. 1997 “Për përfitim nga Statusi i të Verbërve”.

S.Ç ka paraqitur pranë Bashkisë Korçë, Vërtetimin me datë 25.10.2019, sipas të cilit vërtetohet se për vitin akademik 2019-2020 ka qenë frekuentues i Kursit të II-të. Ky shtetas ka përfituar pagesën 300% edhe për vitin akademik 2019-2020, pasi ka paraqitur vërtetimin me datë 25.10.2019, lëshuar nga Universiteti i Korçës, Fakulteti i Bujqësisë.

Referuar vërtetimit të sipërpërmendur rezulton se S.Ç, ka qenë frekuentues i programit të studimit Kursi i II-të, për vitet akademike 2019-2020.

Shtetasi S.Ç pretendon se për vitin akademik 2019-2020 nuk ka mundur të ndjekë procesin mësimor, për shkak të gjendjes shëndetësore, dhe e ka lënë duke i vazhduar studimet një vit më vonë.

Ndërkohë bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje rezulton se ky shtetas ka frekuentuar procesin arsimor për vitet 2019-2020. Shtetasi pretendon se ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore, por nuk ka paraqitur asnjë dokument zyrtar të lëshuar nga institucionet përkatëse, që të vërtetojë këtë pretendim.

Në interpretim të pikës 7, të VKM 277, datë 18.06.1997, përfitimi i pagesës (një vit shtesë përtej ciklit normal të studimit) në masën 300%, nuk është rregull, por rast përjashtimor. Që të kryhet kjo pagesë përtej ciklit normal të studimit duhet që përfituesi i pagesës minimalisht të vërtetojë shkakun ose arsyet të cilat e kanë penguar të ndjekë rregullisht studimet brenda vitit të caktuar akademik.

Bashkia Korçë, pasi ka administruar të gjithë dokumentacionin, ka konkluduar se personi në fjalë, jo vetëm që nuk ka provuar pretendimin e tij, por nga dokumentacioni që disponojmë, vërtetohet se ka qenë frekuentues për vitin akademik 2019-2020.

Ne si institucion kemi vepruar në zbatim të legjislacionit përkatës, duke u përpjekur që në çdo moment të shmangim rastet e abuzimit, përse i përket pagesave shtesë, një vit përtej ciklit normal të studimit.

Dokumentacioni provues i kërkuar është një kërkesë legjitime dhe e drejtë nisur nga kushtet specifike që ka rasti konkret. Kjo kërkesë vjen në zbatim të Kodit të Procedurës Administrative.

Në përfundim gjykojmë se, ndërprerja e pagesës është kryer konform ligjit dhe se kryerja e pagesës për vitin plus nuk është e justifikuar. Gjithashtu ju bëjmë me dije se, institucioni jonë është shumë sensitiv ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuar dhe në asnjë rast nuk ka diskriminuar, për asnjë shkak të vetëm, këtë kategori”.

Me shkresën nr. 881/1, datë 21.02.2022, Bashkia Korçë dërgoi të njëjtat parashtrime si DRSHSSH Korçë.

Në përgjigje të DRSHSSH, ankuesi nëpërmjet përfaqësues së zyrës së Komisionerit në Korçë, me e-mail-in datë 24.03.2022 ka informuar se: “Ka qenë i regjistruar pranë Fakultetit të Bujqësisë, Programi i studimit “Menaxhim Biznesi Bujqësor”. Në vitin 2018-2019 ka mbaruar vitin e parë dhe më pas është regjistruar në vit të dytë 2019-2020. Në vitin e dytë për shkak të pandemisë nuk ka frekuentuar rregullisht të gjitha lëndët dhe ka ngelur në disa provime të cilat e kanë detyruar të vazhdojë studimet edhe në vitin 2020-2021, ku ka bërë pagesën e shkollës. Ky quhet vit i mbartur. Është bërë pagesa e bursës për 2 muaj nëntor-dhjetor 2020 dhe më pas i është ndërprerë, si shkak i ndryshimit të ligjit ku nuk mund të jenë përfitues të kësaj burse 1 vit

shtesë. Edhe pse ai ka çuar dokumentet që e vërtetojnë se vazhdon shkollën, siç është vërtetimi i pagesës dhe i frekuentimit të shkollës, përsëri nuk është pranuar”.

Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 22, datë 01.02.2022, Komisioneri me shkresën nr. 223/4, datë 21.04.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.05.2022², për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

- Kopje të plotë të dosjes së përfitimit të trefshit të pagesës për ndjekjen e arsimit të lartë të ankuesit, për vitet akademike: 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021.
- Ankuesi të dërgojë prova, se ka dorëzuar pranë DRSHSSH Korçë ose Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, arsyen/t e mosfrekuentimit të studimeve, për vitin akademik 2019-2020 dhe që ka kërkuar përfitimin e pagesës dhe për vitin akademik 2020-2021.

Në përgjigje të njoftimit për seancën dëgjimore, DRSHSSH Korçë me e-mail-in datë 28.04.2022, informoi se: *“Pasi u morën në shqyrtim të gjitha shkresat, përsa i përket drejtorisë sonë, ne nuk kemi asnjë pretendim dhe pagesat mund të kryhen vetëm nëse personat pretendues paraqesin vërtetimet e shkollës për vitet e prapambetura, për të cilat pretendojnë pagesat”.*

Në vijim të procedurës hetimore, Bashkia Korçë me shkresën nr. 3089/1, datë 12.05.2022, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pas kontakteve të marra me ankuesit në bashkëpunim dhe me përfaqësuesen e zyrës së KMD-së, këta shtetas kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, për shlyerjen e pagesave të prapambetura. Për sa më sipër, çështja u zgjidh me ndërmjetësimin e KMD-së dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë”.*

Në vijim ankuesi me shkresën e dërguar me e-mail-in datë 12.05.2022 dhe me postë me datë 17.05.2022, informoi Komisionerin se tërhiqet nga ankesa, pasi kërkesa e tij për përfitimin e pagesës për vitin shtesë të studimeve ishte realizuar me ndërmjetësimin e palëve në proces.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëron se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e*

² Me e-mail-in datë 04.05.2022, përfaqësuesja e Bashkisë Korçë informoi se për arsye shëndetësore dhe familjare, kërkon shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore.

Me e-mail-in datë 28.04.2022, përfaqësuesja e DRSHSSH Korçë informoi se nuk kanë parashtrime të tjera lidhur me çështjen dhe për arsye të ngarkesës në punë, nuk mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore.

Me e-mail-in datë 05.05.2022, palët u informuan për shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore, për në datë 13.05.2022.

nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 22, datë 01.02.2022, të S.Ç, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA